



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.337/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Ymer Hoxha anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e organizatës BIRN dhe Internews Kosova (IKS) me seli në Prishtinë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Nisma për Kosovën ZL.Anr.337/2017 e datës 22.10.2017 e parashtruar kundër subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

#### A r s y e t i m

Më datën 22.10.2017, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga organizata BIRN dhe Internews Kosova (IKS), ku pretendon se kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Gjakovë, Valentina Alijaj, në rrjetin social Facebook me datën 22.10.2017 rreth orës 01:10 të mesnatës ka dërguar fotografi me përmbajtje të logos dhe numrit të partisë që ajo përfaqëson si dhe numrin e saj si kandidate. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është shkelur neni 36 par.1 pika b) e LZP.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë si dhe në cilësi të dëshmitarit ka shënuar emrin e monitoruesit të tyre me të cilën ka deklaruar se ka pranuar këtë mesazh në rrjetin social.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha dëshmit relevante në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës BIRN dhe Internews Kosova, lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e kandidates për Kuvend Komunal në Komunën e Gjakovës nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, Paneli i vlerësoj se janë pa qëndrueshme dhe si e tillë e refuzoj ankesën, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të nenit 36.1 pika b) e LZP-së, për arsye se nga provat e administruara në këtë rast nuk janë vërtetuar pretendimet ankimore se kandidatja në fjalë ka thyer heshtjen zgjedhore për zgjedhjet lokale të datës 22.10.2017, sepse nga fotografit që gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet koha dhe data e shpërndarjes së postimit lëndor.

Nga arsyet e theksuar më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.337/2017 më datën 22.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

**Adnan Konushevci**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.